



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 198 Prot.

Tiranë, më datë 24.04.2026

VENDIM
Nr. 141, datë 24.04.2026

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 24.04.2026:

VENDOSI

- Miratimin e projektit “Rikonstrukcion i shtëpisë së rrënuar 2 katëshe”, Brenda Kufirit Qendër Historike Elbasan, me aplikues Z. Saimir Vukaj dhe zhvillues **Z. Andi Bejleri, me rekomandimin:**
 - Të respektohet rekomandimi i lënë në Vendimin e KKTKM-së nr. 142 datë 28.02.2025;
 - Të realizohen nga DSHA sondazhe arkeologjike në pjesën përreth objektit me investigimin e potencialit arkeologjik të nëntokës;
- Shpenzimet për realizimin e sondazheve do të mbulohen nga zhvilluesi sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 143, pika 2;
- Rezultati i sondazheve arkeologjike duhet të paraqitet për shqyrtim dhe vendimmarrje në KKTKM;
- Gjatë procesit të zbatimit punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 72, pika 1 dhe 2;
- Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
- Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
- Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Endri HAXHIU

